



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2020:044331

Datë: 08.07.2021

Numri i dokumentit: 01974771

**C. nr. 217/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.K. nga ....., të cilën e përfaqëson me autorizim F. S., bashkëpuntor profesional, në zyrën e avokatit Selmon Sadiku nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim dhe shpërblimin jubilar, me vlerë të kontestit 1.556,00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 07.07.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit V.K. nga ..... dhe;

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim, për 673 ditë pune, t'ia paguajë shumën prej 1.346.00 euro (njëmijë e treqind e katërdhjetë e gjashtë) dhe atë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017, e deri më datën 17.04.2021, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 06.03.2020, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë përmes të cilës paditësi ka kërkuar që në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune, në lartësi prej 50%, të një page bazë, ti kompenzohet shumën prej 210.00 euro (dyqind e dhjetë), **REFUZOHET SI E PA BAZUAR.**

**IV. REFUZOHET** kërkesa e të autorizuarit të paditësit – bashkëpuntorit profesional të zyrës së avokatit Selmon Sadiku nga Kamenica, për kompenzimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 269.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, **SI TËRËSISHT E PABAZUAR.**

## **A r s y e t i m**

Paditësi V.K. nga ....., përmes të autorizuarit të tij S.S., avokat nga Kamenica, më datën 06.03.2020, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim dhe shpërblimin jubilar, me vlerë të kontestit prej 1.556,00 euro.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 401, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), nuk e ka konvokuar fare seancën përgaditore por, e ka caktuar drejtpërdrejt seancën e shqyrtimit kryesor, ngase duke u bazuar në shkresat e lëndës është vlerësuar se kjo çështje juridike kontestimore nuk është e ndërlikuar.

### **1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

I autorizuari i palës paditëse, F. Sp., në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.07.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, por që në seancë e shqyrtimit kryesor e ka precizuar kërkesëpadinë, ashtuqë e ka zmadhur të njëjtën, duke kërkuar nga gjykata që të konsiderohet si objekt kontesti periudha kohore prej datës 18.04.2017, e deri me datën 17.04.2021, tutje ka shtuar se kjo periudhë kohore përfshinë 673 ditë pune, e duke i shumëzuar me 2 euro, paditësit i takojnë 1.346.00 euro ne emër të shujtës ditore, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite përvojë pune i takon 50% e një pagë bazë në shumë prej 210.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 1.556,00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, ndërsa në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 269.00 euro, dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 euro, në emër të taksës gjyqësore shumë prej 30.00 euro dhe në emër të përfaqësimit në seancën e shqyrtimit kryesor shumë prej 135.00 euro.

I autorizuari i palës së paditur, Alban Hashani, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 07.07.2021, ka deklaruar se mbetën në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe ka shtuar se të njëjtit nuk janë nënshkruar të kësaj Kontrate Kolekive të Arsimit në Kosovë, poashtu ka shtuar se e njëjta nuk është e regjistruar dhe për neve si Drejtori Komunale e Arsimit, nuk paraqet ndonjë detyrim, andaj, edhe nuk kemi legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, si dhe një kërkesë e tillë e paditësit është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ me numër 12/2011 dhe ndryshim – plotësimit të Udhëzimit Administrativ me numër 05/2020, ndërsa tutje ka shtuar se paditësi nuk ka arritur ta vërtetojë kërkesën e tij, poashtu i njëjti e ka kundërshtuar kërkesën lidhur me shpërblimin jubilar dhe të shpenzimeve të suhqimit ditor si të pa bazuara, e gjithëashtu i ka kundërshtuar pjesërisht edhe provat e propozuara nga paditësja, e përveç këtyre i ka kundërshtuar edhe shpenzimet e procedurës të kërkuara nga i autorizuari i paditësit si të pa bazuara në ligj. Andaj, mbi këto të lartëcekura i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadija e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

### **2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: kontrata e punës me nr. 23, e datës 27.09.2013, e lidhur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në Komunën e Kamenicës si punëdhënës dhe V.K. si punëmarrës, vërtetimi me nr.133, i datës 27.12.2019, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë, vendimi me nr.521, i datës 08.10.2019, i lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Kamenicës, lista e pagave më numër EM00114073, në emër të V.K., kërkesa e paditësit V.K. drejtuar DKA-së, në Kamenicë, me nr.04-1571, e datës 22.01.2020, përgjigja me shkrim e DKA-së, në Kamenicë ndaj V.K., me nr.04-3937, e datës 10.02.2020, vërtetimi me nr.136, i datës 02.07.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica dhe vërtetimi me nr. 85, i datës 30.06.2021, i lëshuar nga SHMU “Fan S. Noli” nga Kamenica.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, konform dispozitës së nenit 8, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për këto arsye:

Për palët ndërgjygjëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka punuar te e paditura, por për të padituren kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit.

Nga kontrata e punës me nr. 23, e datës 27.09.2013, e lidhur në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në Komunën e Kamenicës si punëdhënës dhe V.K. si punëmarrës, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura, më datën 01.09.2013, me kohë të pacaktuar, si mësimdhënëse klasor.

Nga vërtetimi me nr.133, i datës 27.12.2019, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi V.K. prej datës 13.09.2019 është ttransferuar përkohësisht nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në Kamenicë, në SHFMU “Fan S. Noli” në Kamenicë, që të kryer punët si arsimtar i Historisë.

Nga vërtetimi me nr.133, i datës 27.12.2019, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, në Kamenicë gjykata e vërtetoj faktin se paditësi V.K., është i sistemuar në këtë shkollë si mësimdhënës lëndor prej datës 01.09.2011 e deri më datën 13.09.2019.

Nga kërkesa e paditësit V.K., drejtuar DKA-së, në Kamenicë, me nr.04-1571, e datës 20.01.2020, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi, paraprakisht i’u është drejtuar të paditurës me kërkesë për realizimin e të drejtës së saj për kompenzimin e shpenzimeve për ushqim dhe të shpërblimit jubilar, por të njëjtës i është refuzuar kërkesa si e pa bazuar.

Nga përgjigja me shkrim e DKA-së, në Kamenicë ndaj V.K., me nr.04-3937, e datës 10.02.2020, gjykata e vërtetoj faktin se e paditura i’a ka refuzuar kërkesën për kompenzim të shpenzimeve për ushqim dhe të shpërblimit jubilar paditësit V.K., si të pabazuar.

Nga vërtetimi me nr.136, i datës 02.07.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica, gjykata e vërtetoj faktin se paditësi V.K. ka të kaluara 421 ditë pune – mësimi, për periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri më 12.09.2019.

Nga vërtetimi me nr. 85, i datës 30.06.2021, i lëshuar nga SHMU “Fan S. Noli” nga Kamenica, gjykata e vërtetoi faktin se paditësi V.K. ka të kaluara 252 ditë pune – mësimi, për periudhën kohore prej 11.03.2020 e deri më 17.04.2021.

### **3. Ndryshimi i padisë**

I autorizuari i paditësit F. S., në fillim të seancës së shqyrtimit kryesor të datës 07.07.2021, meqenëse gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 401 të LPK-së, nuk e ka konvokuar fare seancën përgaditore, e ka ndryshuar kërkesëpadinë, ashtuqë në vend të shumës prej 1.211,97 euro, e ka zmadhuar të njëjtën në shumë prej 1.556,00 euro me arsyetimin se tani i ka siguruar vërtetimin e ditëve në punë me nr. 136, të datës 02.07.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica dhe vërtetimi me nr. 85, i datës 30.06.2021, i lëshuar nga SHMU “Fan S. Noli” nga Kamenica, ngase në kohën e paraqitjes së padisë nuk ka qenë e mundur të sigurohen këto vërtetime.

Gjykata, pas kësaj i'a ka dhënë të drejtën e deklarimit përfaqësuesit të palës së paditur dhe i njëjti e ka kundërshtuar ndryshimin e padisë së paditëses si të pabazuar.

lidhur me këtë e duke u bazuar në dispozitën e nenit 258, paragrafi 4, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se *“Gjykata në rastin e paragrafit 2 të këtij neni e lejon ndryshimin e padisë edhe po që se i padituri e kundërshton ndryshimin në qoftë se plotësohen këto kondita: a) paditësi, pa fajin e tij, nuk ka mundur më parë ta ndryshojë padinë; b) i padituri ka mundur të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes të ngritur me padinë e ndryshuar pa u shtyrë seanca kryesore”*, gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka mundur që vërtetimin e ditëve në punë me nr. 136, të datës 02.07.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica dhe vërtetimi me nr. 85, i datës 30.06.2021, i lëshuar nga SHMU “Fan S. Noli” nga Kamenica, t'i siguroj më herët dhe të njëjtit t'i paraqes si provë së bashku me paraqitjen e padisë, e poashtu gjykata ka konsideruar se i autorizuari i të paditurës ka pasur mundësi të marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor pa pasur nevojë që e njëjta të shtyhet, madje edhe a'i vetë nuk ka kërkuar që seanca gjyqësore të shtyhet, e duke i marrë parasysh të gjitha këto gjykata me aktvendim procedural e ka lejuar ndryshimin e padisë dhe si vlerë të kontestit e ka konsideruar shumën prej 1.556.00 euro.

### **4. Baza juridike**

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe përcaktimit të lartësisë për shujtën ditore në shumë prej 2 euro në ditë, për 673 ditë pune është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.202, të nënshkruara në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me anë të së cilës, mes tjerash, punëdhënësi (në këtë rast DKA, në Komunën e Kamenicës), obligohet që punëmarrësit t'ia kompensojë shpenzimet në emër të ushqimit dhe shpërblimit jubilar.

Bazuar në nenin 35, paragrafi 7, të dy Kontratave Kolektive të lartëcekura, ku përcaktohen të drejtat e të punësuarve për kompenzimin për ushqim gjatë punës, e që është paraparë që për një ditë pune të punësuarit t'i kompenzohet me nga 2 euro, në këtë kuptim paditësi rezulton të ketë kaluar 673 ditë pune, për vitet shkollore 2016 – 2017, 2017 – 2018, 2018 – 2019, 2019 – 2020 dhe 2020 – 2021, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi me nr. 136, të datës 02.07.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica dhe vërtetimi me nr. 85, i datës 30.06.2021, i lëshuar nga SHMU “Fan S. Noli” nga Kamenica, e që duke i shumëzuar me 2 euro, del të jetë shuma e përgjithshme prej 1346.00 euro, shumë kjo e vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në dispozitën e nenin 90, paragrafi 6, të Ligjit të Punës me Nr.03/L-212, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”*, poashtu konform dispozitës së nenit 245, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Nr.04/L-077, ku përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbatjen e tij”*, gjykata mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore të lartëcekura e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e detyroj të paditësit që t'a përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses, të cekur - përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë të refuzuar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me kërkesën për shpërblimin jubilar në lartësi prej 50%, të një page bazë, në shumë prej 210.00 euro, gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 7, paragrafi 1, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* si dhe në dispozitën e nenit 319, paragrafi 1, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjygjëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, dhe duke e pasur parasysh që paditësi nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për ta dëshmuar se i njëjti më të vërtetë i ka së paku 10 vite përvojë pune edhe pse i njëjti i ka ofruar disa vërtetime për ta dëshmuar përvojën e punës, por, megjithatë pas vlerësimit nga ana e gjykatës të secilit prej tyre veç e veç dhe me kujdes, nuk është vërtetuar fakti se paditësi i ka arritur 10 vite përvojë pune në institucionet arsimore, në mënyrë që të njëjtit t'i takoj e drejta e shpërblimit jubilar në lartësi prej 50% të një page bazë, ashtuqë vërtetimeve për përvojën e punës të dorëzuara si prova materiale nga ana e paditësit, gjykata nuk u'a fali besimin dhe nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ngase përmes tyre nuk mund të vërtetohej se paditësi i ka arritur 10 vite përvojë pune në institucionet arsimore, madje i njëjti sipas vlerësimit të gjykatës nuk i ka arritur 10 vite përvojë pune në institucionet arsimore as deri në Kohën kur është vendosur mbi këtë çështje juridike kontestimore, e në rastin konkret nuk mund të vërtetohet pretendimi i palës paditëse se i njëjti i ka 10 vite përvojë pune në institucionet arsimore, andaj gjykata ka vendosur që shumën prej 210.00 euro, të kërkuar në emër të shpërblimit jubilar, përtej asaj të gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në mungesë të provave t'a refuzojë si të pabazuar.

##### **5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Andaj, duke u bazuar në dispozitën e lartëcekur të dy Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, dispozitave tjera ligjore të lartëcekura si dhe në gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të padituren, që paditësit në emër të kompenzimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve në punë, t’ia paguaj shumën e specifikuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar fakti se paditësi V.K. nga fshati Koretin, Komuna e Kamenicës, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më 17.04.2021, ka qenë në vendin e punës për 673 ditë dhe këtë faktë gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit me numër 136, të datës 02.07.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët e Kombit” nga Kamenica dhe vërtetimit me nr. 85, i datës 30.06.2021, i lëshuar nga SHMU “Fan S. Noli” nga Kamenica, e të cilave prova gjykata u’a falë besimin e plotë, ngase janë dokumente publike, të lëshuara nga organi kompetent dhe nga personi i autorizuar, respektivisht të lëshuara nga vet e paditura, e rrjedhimisht i mori për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ndërsa edhe pse paditësja paraprakisht kishte kërkuar nga e paditura që të njëjtës t’i kompensohen shpenzimet për ushqim dhe për shpërblimin jubilar, e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, në Komunën e Kamenicës, nuk e ka përmbushur obligimin e saj, siç e ka pasur detyrim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit, në Kosovës, të datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve buxhetore për kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe të shpërblimit jubilar, të specifikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, fakt ky i vërtetuar nga përgjigja me shkrim e të paditurës ndaj paditëses, me nr.04-3937, e datës 10.02.2020, e lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e Kamenicës.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur, se kërkesëpadia e paditëses për kompenzimin e ushqimit për ditët në punë dhe të shpërblimit jubilar në lartësi prej 50%, të një page bazë, është në tërësi e pa bazuar dhe e njëjta ta refuzohet si e tillë, për faktin se paditësi me asnjë provë nuk ka arritur ta vërtetojë kërkesëpadinë e tij, si dhe faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e cekur si më lartë nuk paraqet ndonjë detyrim për të paditurën dhe se e njëjta nuk ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, si dhe faktin se një kërkesë e tillë e paditëses është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ me numër 12/2011 dhe ndryshim – plotësimin të Udhëzimit Administrativ me numër 05/2020, për gjykatën këto pretendime ishin pjesërisht si të pa bazuara, për faktin se me nenin 2, të Kontratës Kolektive të lartëcekur, të gjitha Drejtorit Komunale të Arsimit, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, poashtu duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4, pika 2, të kësaj kontrate Kolektive të lartëcekur, paditësi me pozitë të punës mësimdhënëse klasor, hynë në kuadër të pëfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë Kolektive e Arsimit. Andaj, edhe përgjegjësia për kompenzim të shpenzimeve për ushqim ditor është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë. E duke u bazuar në të lartëcekurat, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar në ligj dhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë, në shumë prej 210.00 euro, të cilën e ka kërkuar paditësi, në emër të shpërblimit jubilar, gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi nuk ka arritur që t’a provoj gjatë shqyrtimit kryesor përmes provave relevante, se të njëjtit i takon edhe kjo shumë e kërkuar e të hollave, ngase nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për ta provuar

faktin se i njëjti i ka arritur 10 vite përvoj pune në insitucionet e arsimit në Kosovë, madje as deri në ditën kur është vendosur mbi këtë çështje juridike kontestimore dhe në mungesë të provave konkrete dhe relevante, ka ardhur në përfundim se kjo pjesë e kërkesëpadsisë e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar dhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata në lartësinë e aprovuar për kompensimin e shpenzimeve për ushqim, paditësit i'a ka njohur të drejtën e kamatës ligjore prej 8%, nga data 06.03.2020, si datë e paraqitjes së paditës e deri në pagesën definitive, dhe atë në kuptim të nenit 382, paragrafi 2, të LMD-së.

#### **6. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Poashtu, gjykata ka vendosur që kërkesën për kompenzimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore, të të autorizuarit të paditësit – bashkëpunorit profesional të zyrës së avokatit Selmon Sadiku nga Kamenica, ta refuzoj si të pabazuar në ligj, ngase një kërkesë e tillë nga bashkëpunori profesion i zyrës së avokatit, është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe në kundërshtim me Tarifen e Odës së Avokatëve të Kosovës, ngase shpenzimet e procedurës i njihen vetëm avokatit të licencuar, por, jo edhe bashkëpunorve të zyres së avokatit. E duke i pasur parasysh këto fakte, gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e ka refuzuar një kërkesë të tillë.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe dispoziten e nenit 245 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Nr.04/L-077, e lidhur me nenet 7, 319 dhe 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C. nr.217/2020, i datës 07.07.2021**

**G j y q t a r i**

**Artan Abazi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:044331  
Datë: 08.07.2021  
Numri i dokumentit: 01974771